

RAPORT VJETOR 2023



Realizuar nga Administrata e U.P.SH.

Nën kujdesin e Presidentes Znj.Valbona Treska

RAPORT VJETOR 2023

© URDHRI I PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË



Tabela e lëndës

Përshëndetje e Presidentit.....	5
1. Rrugëtimi i institucionit gjatë vitit 2023.....	7
1.1 Dita Ndërkombëtare e Shëndetit Mendor.....	17
2. Organet e Urdhrit të Psikologut dhe aktiviteti i tyre funksional.....	19
2.1 Asambleja Kombëtare	20
2.2 Këshilli Kombëtar.....	22
2.3 Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional.....	27
2.4 Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji.....	28
2.5 Administrata e Urdhrit të Psikologut.....	29
2.6 Komisione të tjera.....	30
2.6.1 Komisioni Licencimit.....	30
2.6.2 Komisioni i Praktikës Profesionale.....	31
2.6.3 Komisioni i Vlerësimit të Aftësisimit Praktik.....	31
2.7 Koordinatorët Lokalë.....	33
3. Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut.....	35
3.1 Psikologë të licencuar.....	35
4. Provimi i shtetit për psikologët.....	37
5. Buxheti.....	38
5.1 Të ardhurat.....	38
5.2 Shpenzimet.....	38
6. Objektivat e realizuar gjatë vitit 2023.....	41
7. Objektivat për vitin 2024.....	42



PËRSHËNDETJA E PRESIDENTIT



(*Dr. Valbona Treska - Presidente*)

Të nderuar,

Në këtë vit të VII-të të funksionimit të institucionit tonë, kemi kënaqësinë të ndajmë me Ju arritjet dhe sfidat që kemi hasur për ta konsoliduar edhe më shumë jo vetëm Urdhrin e Psikologut, por në tërësi profesionin e psikologut.

Gjatë këtij viti kemi patur disa ngjarje të rëndësishme, të cilat kanë shënjuar punën e institucionit dhe politikat e ndjekura. Kemi realizuar për herë të parë provimin e rilicencimit të psikologëve, të cilët nuk kanë plotësuar kreditet e nevojshme në kohë sipas rregulloreve në fuqi. Hartimi i pyetjeve dhe i gjithë orgnizimi i provimit kanë qenë një punë e përbashkët rezultative e një komisioni të posaçëm

ekspertësh në bashkëpunim me administratën e U.P.SH.

Komisioni i Edukimit në Vazhdim ka realizuar një numër rekord mbledhjesh për njohje dhe rishikim kreditesh nisur nga fakti se viti që lamë pas, ka qenë një vit rilicencimesh për anëtarët e Urdhrit. Herë pas here Këshilli Kombëtar ka marrë vendime të rëndësishme për krijimin e lehtësirave për llogaritjen e krediteve për kategori të ndryshëm psikologësh, sipas viteve të tyre të licencimit, duke mbajtur në konsideratë funksionimin e edukimit në vazhdim dhe dinamikat e tij ndër vite.

Këshilli Kombëtar ka marrë gjatë këtij viti vendime shumë të rëndësishme lidhur me ushtrimin e fushës së kompetencës për psikologë të cilët janë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Espertëve të Ministrisë së Drejtësisë. Këto vendimmarrje u pasuan nga një sërë procedimesh disiplinore, për të gjithë ata ekspertë psikologë të cilët e ushtronin profesionin jo në përputhje me legjislacionin në fuqi. Tashmë, në një moment konsolidimi institucional, lind detyra e secilit nga ne që të punojmë për të rritur standardet profesionale, me qëllim që t'u ofrojmë qytetarëve një shërbim sa më cilësor dhe të strukturuar.

Në fokus të institucionit ka qenë specifikisht gjatë këtij viti strukturimi i punës së psikologëve që punojnë në strukturat policore. Që në fillimet e këtij shërbimi, roli i psikologut në polici ka marrë një rëndësi të veçantë dhe puna e këtyre kolegëve është bërë gjithmonë e më shumë domosdoshmëri për organizatën e policisë. Nisur nga këto nevoja të organizatës për shërbim cilësor dhe të dedikuar të psikologëve, kemi realizuar takime, diskutime, lobime mbi mirëpozicionimin e psikologut në strukturë. Në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe Programin EU4LEA kemi bashkërenduar punën për hartimin e përshkrimeve të reja të punës së psikologut në polici. Ky përshkrim i ri i pozicionit të psikologut, shoqëruar me kriteret përkatëse të punësimit të profesionistëve në Policinë e Shtetit, u përmyll me



URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



miratimin e përshkrimeve të reja të punës nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Muhamet Rrumbullaku. Miratimi i këtij dokumenti është në vazhden e fokusit që i kemi dhënë psikologut në polici dhe botimit të Udhëzuesit “Roli i Psikologu në Polici”, prodhim gjithashtu i bashkëpunimit të institucioneve tona.

Nuk mund të ngelte jashtë fokusit të rrugëtimit tonë të 2023-it, trajnimi i posaçëm për psikologët në drejtësi. Ky trajnim lindi si nevojë për t’u realizuar pas trajnimeve të të njëjtit lloj të 2018-2019, si pasojë e kërkesës së lartë të sistemit të drejtësisë për profesionistë psikologë në të dyja nivelet, psikologë asitues dhe psikologë vlerësues. Finalizimi i trajnimit kërkoi një përgatitje mjaft të gjatë në kohë, me aplikime, komisione të ngritura për përzgjedhjen e kandidatëve, rishikimin e moduleve të trajnimit dhe, mbi të gjitha, në përzgjedhjen e lektorëve shumë profesionistë të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar. Në total morën pjesë 18 psikologë në modulën e parë si asistues dhe 16 psikologë në modulën e dytë si vlerësues. Në një maratonë fundjavash kolegët morën informacionin bazë të nevojshëm, për të qenë ekspertë në këtë fushë. Profesori i psikologjisë forensike me famë ndërkombëtare Ray Bull, ishte ndër emrat e nderuar të lektorëve të këtij trajnimi. Pjesëmarrja e tij në trajnim u parapri nga një leksion i hapur i niveleve shumë të larta ndërkombëtare mbi teknikat e intervistimit të psikologut në polici.

Viti 2023 ishte viti që përkoi me përfundimin e mandatit të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor dhe rizgjedhjen e komisionit të ri. Tashmë pjesë e këtij komisioni janë 8 psikologë me eksperiencë në fusha të ndryshme të psikologjisë, të cilët do të gjykojnë çështje të adresuara për shkelje të standardeve etike.

Një tjetër ngjarje e rëndësishme gjatë këtij viti, ishte edhe Dita Botërore e Shëndetit Mendor, 10 Tetor, e kthyer tashmë në traditë për t’u promovuar. Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës u vendosën fjongo të mëdha të gjelbra në të gjithë autobusët e linjave kryesore të qarkullimit në kryeqytet. Fjongoja e gjelbër, simbol i ditës së Shëndetit Mendor ishte një simbol që tërhoqi vëmendje e mijëra qytetarëve dhe padyshim, ndihmoi në promovimin e të tjera aktiviteteve gjatë asaj dite për këtë kauzë të përbashkët. Në zona të frekuentuara të Tiranës u shpërndanë fletëpalosje me mesazhe sensibilizuese

për qytetarët. Aktivitetet u pasqyruan në median vizive dhe të shkruar, si një prej ngjarjeve më të rëndësishme të asaj dite.

Urdhri i Psikologut ka vijuar të jetë pjesë aktive edhe gjatë këtij viti e organizmave të rëndësishëm ndërkombëtarë siç janë Federata Evropiane e Psikologëve (EFPA), Aleanca Globale e Psikologjisë, Shoqata Evropiane e Punës dhe Psikologëve Organizacionalë (EAWOP) dhe Shoqata Amerikane e Psikologjisë (APA).

Një nga sukseset më të mëdha të Urdhrit të Psikologut gjatë vitit 2023 në arenën ndërkombëtare ka qenë marrja e stafetës për organizimin e semestrin të psikologjisë të Federatës Evropiane të Shoqatave të Psikologëve për periudhën Janar – Qershor 2024. Ky është një nga eventet më të mëdha evropiane, që do të kulmojë me realizimin e mbledhjes së presidentëve të EFPA-së në Tiranë në Maj 2024. Pa dyshim, me bindje të plotë, e them se ky do të jetë një nga vitet më të rëndësishëm të psikologjisë dhe psikologëve në Shqipëri.

Uroj që gjatë vitit 2024 të kemi të tjera arritje së bashku në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, të punojmë bashkë në fuqizimin e rolit të psikologut në shoqëri, të rrisim vendet e punës, të nxisim institucionet të ndryshojnë vizionin e tyre për punësimin e psikologëve, dhe mbi të gjitha, t’i ofrojmë çdo qytetari shërbim profesional dinjitoz.

Përzemërsisht,
Dr. Valbona Treska

Tiranë, Shqipëri, Janar 2023



1. RRUGËTIMI I INSTITUCIONIT GJATË VITIT 2023

Gjatë viti 2023, Urdhri i Psikologut, vazhdoi angazhimin e tij institucional në përmbushje të misionit të tij. Pavarësisht vështirësive dhe sfidave për të realizuar aktivitetin tonë të përditshëm, kemi arritur që edhe gjatë këtij viti të kemi një sërë aktivitete të suksesshme.

Janar

Gjatë këtij muaji kemi zhvilluar mbledhje online me anëtarësinë e Urdhrit të Psikologut në kuadër të procesit të rilicencimeve, të shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave të anëtarësisë, me qëllim përfitimin e krediteve të nevojshme për rilicencim, si dhe për të diskutuar dhe vlerësuar me kujdes problematikat e hasura nga anëtarët.

Në 28.01.2023 u mbushën plotë 6 vite nga themelimi i Urdhrit të Psikologut.




Shkurt

Gjatë muajit shkurt ka vijuar puna për anëtarësimet e reja dhe trajtimin e problematikave të referuara nga anëtarët e Urdhrit të Psikologut. Gjithashtu kanë vijuar edhe takimet ndërinstitucionale për të promovuar rolin dhe rëndësinë e psikologut në institucione dhe shoqërinë në përgjithësi.

Mars

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zhvilloi në datat 6-7 Mars 2023, në Pallatin e Kongreseve, Kongresin e parë të Shëndetësisë. Ky kongres bëri bashkë të gjithë aktorët që mund të japin kontributin e tyre për një shërbim më cilësor, më shumë përkujdesës dhe inovator. Urdhri i Psikologut ishte bashkëpunëtor në këtë kongres dhe pjesëmarrja e psikologëve ishte gjithashtu e rëndësishme, jo vetëm në paraqitjen e punës së tyre, por edhe për të bashkërenduar shërbimin me kolegë të tjerë të shëndetësisë, me qëllim përmirësimin e shërbimit.





Në datë 10.03.2023 u zhvillua takimi i përfaqësuesve të vendeve anëtare të EuroPsy në zyrat qendrore të EFPA's në Bruksel. Prej kohësh Urdhri i Psikologut ka qenë i angazhuar në njohjen dhe nisjen e procedurave për pajisjen me certifikatat EuroPsy. Këto certifikata do t'u mundësojnë mobilitet psikologëve tanë, për të ushtruar profesionin në të gjithë Evropën. Urdhri i Psikologut gjatë vitit 2023 punoi për rishikimin e të gjithë programeve bachelor dhe master në Psikologji në të gjithë universitetet në vend, hartimin e raportit dhe aplikimin final, me qëllim ngritjen e Komisionit Kombëtar të Certifikimit EuroPsy.



Në fund të muajit Mars përfundoi me sukses seminari 3 ditor mbi "Rolin e Psikologut në Polici" si një bashkëpunim mes Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë dhe BE EU4LEA.



Prill

Federata Evropiane e Psikologëve (EFPA), me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit, në datë 7 Prill 2023, rikujtoi 75 vjetorin e krijimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. OBSH vijon edhe sot të luajë një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e



shëndetit publik në mbarë botën. EFPA bëri thirrje për njohjen e rëndësisë së shëndetit mendor, të diskutohet më shumë rreth tij dhe që politika, në çdo kohë ta konsiderojë atë si një faktor shumë të rëndësishëm. Thirrja e OBSH-së për më shumë shërbime të ofruara për shëndetin mendor ndaj komunitetit, është një element shumë i rëndësishëm, i cili reflekton edhe faktin e ndryshimit që ka pësuar qasja e individëve ndaj problematikave të shëndetit mendor, përgjatë 75 viteve të fundit.

Maj

Urdhri i Psikologut në mbështetje të legjislacionit në fuqi, rregulloreve si dhe vendimeve të fundit të Këshillit Kombëtar, në kuadër të specializimit të psikologëve, të cilët janë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve, si dhe për psikologët që ofrojnë shërbimin pranë institucioneve të drejtësisë, organizoi tre module trajnimesh të cilat në këtë raport vjetor po i paraqesim sipas muajve kur janë kryer.

Në datat 19-20 Maj 2023 u organizua nga Urdhri i Psikologut trajnimi me temë: “Kuptimi, metodologjia dhe kriteret e vlerësimit psikologjik të stresit post-traumatik në rastin e aksidenteve”. Lektorë të këtij trajnimi ishin: Dr.Valbona Treska, Prof.As.Dr. Valbona Alikaj dhe Msc.Blerina Toma.



Qershor

Në datat 9-10 Qershor 2023 u zhvilluar moduli i dytë i trajnimit me temë: “Roli i psikologut





në kontekstin e vlerësimeve penale dhe sjelljes delinkuente”. Lektorë në këtë trajnim ishin Prof. As.Dr.Vasilika Hysi dhe Msc.Naureda Bajraktari.



Korrik

Në datat 3-6 Korrik 2023 u mbajt në Brighton të Britanisë së Madhe, Kongresi i 18-të i Psikologjisë i organizuar nga *European Federation of Psychologists' Associations* dhe *British Psychological Society*, në të cilin ishte pjesëmarrëse edhe Shqipëria, si vend anëtar i EFPA-s, prej vitit 2019. Mbi 1000 pjesëmarrës me punime shkencore u mbledhën në këtë event kaq të madh profesional.



Në datat 7-8 Korrik 2023, u zhvillua Asambleja e Përgjithshme e EFPA-s. Në këtë mbledhje u miratuan ndryshime të rëndësishme në Statut, ndryshime dhe





URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



propozime në organizim dhe u mandatuan kolegë të rinj. Në këtë aktivitet Urdhri i Psikologut u përfaqësua nga Presidentja Znj.Valbona Treska.



Në datën 11.07.2023, u realizua një takim i Urdhrit të Psikologut, Policisë së Shtetit dhe Programit EU4LEA. Në fokus të këtij takimi ishte fuqizimi i rolit të psikologut në polici.



Në datat 14-15 Korrik 2023 u zhvillua edhe moduli i tretë i trajnimit për psikologët të cilët janë ekspertë të Regjistrimit Elektronik dhe psikologë të cilët punojnë në institucionet e drejtësisë me temë: “Vlerësimi i Çrregullimeve Mendore të prindërve në

çështjet e zgjidhjes së martesës dhe lënies së fëmijëve për rritje dhe edukim”. Në këtë trajnim morën pjesë në cilësinë e lektorëve Dr.Valmira Skëndi dhe Msc. Blerina Toma.





URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Gjatë muajit Korrik, Urdhri i Psikologut priti në ambjentet e zyrës së tij një grup të psikologëve shkollorë, të cilët ushtrojnë profesionin pranë institucioneve arsimore në vend. Ky takim u mbajt, për të diskutuar nga afër mbi problematikat që shqetësojnë këta profesionistë në përditshmërinë e punës së tyre.

Në datë 24.07.2023, u përmbyll procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të Komisionit Etik e Gjykitimit Disiplinor Profesional, proces i cili nisi me aplikimin e kandidatëve, vijoi me dëgjuesën pranë Këshillit Kombëtar të secilit prej tyre dhe u finalizua me vendimin e Këshillit Kombëtar.





URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Në datë 28 Korrik 2023, Shqipëria për herë të parë, u njoftua zyrtarisht nga EFPA, se do të marrë stafetën, për organizimin e Semestrit të Psikologjisë të Federatës Evropiane të Shoqatave të Psikologëve (EFPA) në periudhën janar – qershor 2024. Për të parën herë në 30 vite psikologji, Shqipëria do të mirëpresë Presidentët dhe përfaqësuesit e psikologëve nga të gjitha vendet evropiane anëtare të Federatës. Ky aktivitet është një mundësi shumë e mirë për të treguar jo vetëm punët e mira të bëra nga profesionistët e shqiptarë, por edhe për të promovuar vlerat e vendit tonë.

Gusht

Në datë 12.08.2023, u hapën thirrjet për aplikimin për të marrë pjesë në trajnimin e posaçëm organizuar nga Urdhri i Psikologut, për ekspertë psikologë asistues dhe vlerësues në fushën e drejtësisë.


Shtator

Në shtator kemi vijuar aktivitetet me disa takime të ndryshme në vend, me bashkëpunëtor të Urdhrit të Psikologut. Puna ka vijuar me intensitet në përgatitjen e trajnimit të psikologëve në drejtësi, moduleve dhe bashkërendimit të punës me institucionet e përfshira në proces.

Tetor

Dita e Shëndetit Mendor, në 10 Tetor 2023, u organizua sërish nga Urdhri i Psikologut. Këtë herë të gjithë autobuzët e Tiranës në shenjë sensibilizimi, për një ditë qarkulluan me fjongon jeshile të stampuar, simbol ky i përkujdesjes ndaj shëndetit mendor.

Gjithashtu përgjatë gjithë ditës Urdhri i Psikologut me ndihmën e një grupi vullnetarësh të përbërë nga profesionistë psikologë dhe studentë të psikologjisë, në dy pika kryesore në qendër të qytetit, shpërndau informacione sensibilizuese për qytetarët, në lidhje me rëndësinë e shëndetit mendor.





Nëntor

Në datë 04.11.2023, nisi Moduli i I-rë i trajnimit të Psikologëve në Drejtësi me titull “Psikologët si asistues në sistemin e drejtësisë”.

Në këtë trajnim janë përzgjedhur për të lektuar një grup lektorësh të njohur të fushës, specialistë të sistemit të drejtësisë dhe profesionistë të psikologjisë. Ky bashkëpunim u arrit edhe me mbështetjen e Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjithashtu në këtë rrugëtim të gjatë fundjavash, me një total prej 122 orësh trajnim, Urdhrit të Psikologut iu bashkua edhe Profesor Ray Bull nga “Leicester University”, i cili mban titullin Profesor i Merituar i Psikologjisë Ligjore, me një eksperiencë shumëvjeçare dhe shumë të vyer në këtë fushë.





Në datë 23 Nëntor 2023, u zhvillua në Napoli të Italisë, mbledhja e Këshillit të EFPA-s. Shqipëria u përfaqësua në këtë event nga Presidentja Valbona Treska, e cila prezantoi planin e organizimit të Semestrit të EFPA për periudhën Janar - Qershor 2024. Ky do të jetë padyshim aktiviteti i nivelit më të lartë, i organizuar ndonjëherë në Shqipëri mbi psikologjinë.



Dhjetor

Në 4 Dhjetor 2023, nisi Moduli II-të i trajnimit për psikologët në fushën e Drejtësisë “Psikologët si ekspertë vlerësues në sistemin e drejtësisë”.

Edhe në këtë modul patëm kënaqësinë që të kishim pjesëmarrës lektorët më në zë dhe ekspertë të fushës së psikologjisë.





URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Në 14.12.2023 u mbajt Leksioni i Hapur nga Prof. Raymond Bull me temë: **"Përmirësimi i aftësive të intervistimit të të dyshuarve"**, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, në të cilën morën pjesë afro 100 psikologë. Në leksionin e tij profesor Bull tregoi edhe një herë, se një intervistim profesional, korrekt dhe etik krijon mundësi për një proces cilësor hetimi.

Ky leksion i hap rrugën edhe shumë të tjerëve në fusha të ndryshme të psikologjisë, të cilët do të zhvillohen edhe në kuadër të semestrit të EFPA-s.



Në fundvit, u shpall edhe fituesi i çmimit simbolik të përvitshëm tashmë të organizuar nga institucioni ynë, "Psikologu i Vitit". Këtë vit ndryshe nga vitet e kaluara nuk u vlerësua një por tre fitues me këtë çmim. Grupi i Psikologëve të Policisë Z.Elidon Shehu, Znj. Erisa Velaj dhe Znj.Mirela Tafa, u votuan nga qindra kolegë për kontributin e tyre profesional.

Ata ndihmuan në ndryshimin e përshkrimeve të punës së psikologut në strukturat e Policisë së Shtetit. Pas rreth 13 vitesh shërbim, për herë të parë puna e psikologut po fokusohet specifikisht vetëm në shërbimin psikologjik për punonjësit e policisë.





1.1 DITA NDËRKOMBËTARE E SHËNDETIT MENDOR

Në fokus të punës së Urdhrit të Psikologut ka qënë edhe promovimi i shëndetit mendor si një pjesë përbërëse e rëndësishme e shëndetit në tërësi. Qëllimi i aktiviteteve të dedikuara të kësaj dite synojnë të kthejnë vëmendjen e qytetarëve, institucioneve publike dhe private, organizatave të shoqërisë civile dhe medias drejt shëndetit mendor dhe sfidave me të cilat përballen individët që vuajnë prej tij.



Kështu, në datë 10.10.2023 me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit Mendor, u finalizua me sukses një aktivitet promovues për shëndetin mendor, tashmë i kthyer në traditë. Ndyshe nga një vit më parë, përveç mesazheve sensibilizuese nëpërmjet fletëve informuese, u zgjodh edhe një formë tjetër sensibilizimi. Autobuzët e linjave urbane të Tiranës

gjatë gjithë ditës qarkulluan me fjonon jeshile të stampuar, simbol ky i përkujdesjes ndaj shëndetit mendor.





URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Gjithashtu përgjatë gjithë ditës Urdhri i Psikologut, me ndihmën e një grupi vullnetarësh të përbërë nga profesionistë psikologë dhe studentë të psikologjisë, në dy pika kryesore në qendër të qytetit, shpërndau informacione sensibilizuese për qytetarët, në lidhje me rëndësinë e shëndetin mendor. Fletët sensibilizuese përmbanin të dhëna dhe statistika nga OBSH dhe INSTAT mbi rastet dhe faktorët të lidhurë me shëndetin mendor.


Aktivitet u mbulua gjërësisht nga media vizive dhe e shkruar në vend.





2. ORGANET E URDHRI TË PSIKOLOGUT DHE AKTIVITETI I TYRE FUNKSIONAL

ORGANIGRAMA E URDHRI TË PSIKOLOGUT



Organigrama e Urdhrit të Psikologut

Organet kryesore të Urdhrit të Psikologut janë:

- Asambleja Kombëtare;
- Këshilli Kombëtar;
- Presidenti i Urdhrit;
- Sekretari i Përgjithshëm
- Komisioni Etik i Gjyimit Disiplinor Profesional;

- Komisioni i Edukimit në Vazhdim;
- Komisione të tjera, ku përfshihen aktualisht Komisioni i Licencimit dhe Komisioni i Praktikave Profesionale.

2.1 ASAMBLEJA KOMBËTARE

- Organi më i lartë drejtues i Urdhrit të Psikologut, bazuar në ligjin nr. 40/2016, është Asambleja Kombëtare.
- Asambleja Kombëtare përbëhet nga të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut.
- Asambleja Kombëtare ka këto funksione:
- Zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;
- Miraton statutin e Urdhrit;
- Miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;
- Miraton rregulloren për gjykimin disiplinor profesional;
- Miraton rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe licencimin;
- Miraton rregulloren për organizimin e praktikës profesionale;
- Shqyrton dhe miraton projekt-buxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;
- Analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;
- Shqyrton raportin e auditit të jashtëm, në intervale tre vjeçare.



Në datë 02.06.2023 ora 12:00 u zhvillua në Vlorë në ambjentet e Grand Hotel, mbledhja e Asamblesë së VII-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut me rend dite si më poshtë:

- Fjalë përshëndetëse nga Presidentja Znj.Valbona Treska.
- Fjalë përshëndetëse nga Znj.Veliona Hoxhaj, në cilësinë e Koordinatorës së Qarkut Vlorë.
- Analizë e veprimtarisë vjetore të organeve të Urdhrit të Psikologut nga Sekretare e Përgjithshme e Urdhrit të Psikologut Znj.Elona Mustafaraj.
- Prezantim dhe miratim i buxhetit faktik të vitit 2022, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendimin Nr.18, datë 02.05.2023
- Prezantim dhe miratim i projekt-buxhetit të vitit 2023, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendimin Nr.26, datë 16.12.2022
- Prezantim dhe miratim i ndryshimeve të Statutit të Urdhrit të Psikologut, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendimin



Nr.21, datë 29.05.2023.

- Prezantim dhe miratim i ndryshimeve të Rregullores së Gjykimit Etik e Profesional, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendimin Nr.22, datë 29.05.2023.
- Prezantim dhe miratim i ndryshimeve të Kodit Etik dhe Deontologjik të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me Vendimin Nr.23, datë 29.05.2023.
- Hapësirë e lirë për diskutime.
- Mbyllja e aktivitetit.

Asambleja e VI-të Kombëtare mori këto vendim:

- Të miratojë me unanimitet votash Buxhetin Faktik të vitit 2022.
- Të miratojë me unanimitet votash Projekt-Buxhetin e vitit 2023.
- Të miratojë me unanimitet votash ndryshimet në Statutin e Urdhrit të Psikologut, përkatësisht neni 12, pika 1.d) e tij.
- Të miratojë me unanimitet votash ndryshimet në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor e Profesional, përkatësisht neni 7, dhe neni 13 të saj.
- Të miratojë me unanimitet votash ndryshimet në Kodin Etik e Deontologjik të Urdhrit të Psikologut, përkatësisht Standardet 1.06, 2.01, 2.05 të tij.
- Të miratojë me unanimitet votash shtimin në Kodin Etik e Deontologjik të Urdhrit të Psikologut, të Standardit 5.07.

Pas punimeve të Asamblesë anëtarët patën mundësinë të shpenzonin kohë së bashku duke diskutuar dhe ndarë eksperiencat e tyre. Zhvillimi i Asambleve Kombëtare është jo vetëm një detyrim që rrjedh nga ligji, por edhe një formë për të bashkuar më shumë profesionistët e të gjithë Shqipërisë mes tyre. Asambleja u përmbyll me miratimin e të gjitha pikave të rendit të ditës.



2.2 KËSHILLI KOMBËTAR

KËSHILLI KOMBËTAR



Dr. Valbona Treska



Z. Edvin Lame



Z. Besmir Frroku



Dr. Fleura Shkëmbi



Dr. Manolita Hida




Z. Altin Nika



Znj. Rezarta Basha




Z. Bledar Zeneli



Znj. Valbona Habili



Znj. Artemisi Dono



Znj. Elona Mustafaraj



Znj. Orjola Plaku

Këshilli Kombëtar është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 16 anëtarë.

Anëtarë të zgjedhur të Këshillit Kombëtar janë:

Dr.Fleura Shkëmbi, Dr.Valbona Habili, Dr.Edvin Lame, Dr.Artemisi Dono, Znj.Elona Mustafaraj, Znj. Rezarta Basha, Dr.Manolita Hida, Znj.Orjola Plaku, Z.Besmir Frroku, Z.Altin Nika, Z.Bledar Zeneli,

Në përbërje të Këshillit Kombëtar janë edhe 4 anëtarë të caktuar nga Ministritë, përkatësisht nga:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (njëkohësisht edhe Autoriteti Kompetent i Urdhrit të Psikologut sipas ligjit):

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Mbrojtjes

Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

- a) miraton strukturën e vet organizative;
- b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
- c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar;
- ç) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
- d) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim Asamblesë Kombëtare;
- dh) mban dhe përditëson Regjistrin e Urdhrit të Psikologut;
- e) ngre grupe pune ad-hoc për kryerjen e kontrolleve në ushtrimin e profesionit të psikologut;
- ë) përgatit dhe publikon raportin vjetor dhe financiar.



URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, përgjatë këtij viti ka patur një aktivitet shumë të ngjeshur.

Janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme gjatë vitit 2023 si më poshtë:

- 1- Vendimi Nr.1 datë 03.02.2023** “Të miratojë me unanimitet rekomandimet e grupit Ad-hoc për gjykimin rast pas rasti nga Komisioni i Etikës të psikologëve pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve për tejkalim të fushës së kompetencës, mosrespektim të Urdhrave dhe Rregulloreve të Urdhrit të Psikologut apo mungesës së bashkëpunimit gjatë ushtrimin e profesionit”.
- 2- Vendimi Nr.2 datë 03.02.2023** “Të miratojë me unanimitet honorarin për anëtarët e grupit Ad-Hoc lidhur me vlerësimin e dokumentacionit të depozituar pranë Urdhrit të Psikologut, për psikologët të cilët janë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë në vlerën 10.000 lekë”
- 3- Vendimi Nr.3 datë 03.02.2023** “Të miratojë me unanimitet propozimin e zyrës juridike mbi ndarjen e fushës së kompetencës për kategorinë e psikologëve që kanë përfitur një licencë në të cilën ka më shumë se një titull dhe që janë në proces rilicencimi”.
- 4- Vendimi Nr.4 datë 03.02.2023** “Të miratojë me unanimitet propozimin e zyrës juridike për ndryshimin e procedurës për marrjen e krediteve për aktivitetin e konferencave brenda vendit, në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim”
- 5- Vendimi Nr.5 datë 03.02.2023** “Të miratojë me unanimitet anulimin e Vendimit Nr 4, datë 16.02.2022 të Këshillit Kombëtar lidhur me përcaktimin e tarifës së honorarit për mbledhjet e Këshillit Kombëtar që vijojnë me të njëjtin rend dite në disa mbledhje pasardhëse”.
Pagesa e honorarit do të bazohet në listëprezencën e çdo mbledhje të Këshillit Kombëtar pavarësisht vazhdimit të rendit të ditës në mbledhjen pasardhëse”.
- 6- Vendimi Nr.6 datë 03.02.2023** “Të miratojë me unanimitet honorarin në vlerën 40.000 lekë për hartuesit e moduleve të trajnimit në fushën e Drejtësisë”
- 7- Vendimi Nr.7 datë 03.02.2023** “Të miratojë me 10 vota pro 1 kundër lënien në fuqi të Vendimit Nr.9, datë 22.12.2022 të Komisionit të Etikës.
- 8- Vendimi Nr.8 datë 24.03.2023** “Të miratojë me 10 vota pro 2 kundër propozimin e zyrës juridike për ndryshime në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim në lidhje me uljen e numrit të krediteve për rilicencim për kategorinë e psikologëve që kanë më shumë se 20 vite punë dhe pagesat e supervizimit për këtë kategori”.
- 9- Vendim Nr.9 datë 24.03.2023** “Të miratojë me unanimitet Rregulloren e Provimit të Rilicencimit”.
- 10- Vendimi Nr.10 datë 24.03.2023** “Të miratojë me unanimitet ndryshimin e propozuar në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim për kategorinë Abstrakt/ Poster, Kreu III; C1 e saj”
- 11- Vendimi Nr.11 datë 05.04.2023** “Të miratojë me unanimitet tarifat e honorareve të Komisionit të Provimit të Rilicencimit si dhe pagesat e anëtarëve që do të kryejnë provimin si më poshtë:
 - Honorari për hartuesit e fondit të pyetjeve, 700 lekë/pyetje.
 - Honorari për korigjuesit e Provimit të Rilicencimit, 5.000 lekë/dita.
 - Tarifa bazë e provimit të rilicencimit, 15.000 lekë plus 200 lekë/kredit për diferencën e krediteve që nuk janë plotësuar nga psikologu.
- 12- Vendimi Nr.12 datë 05.04.2023** “Të miratojë me unanimitet plotësimin e Vendimit Nr.7, datë 08.04.2022 të Këshillit Kombëtar, të bëjë të detyrueshëm dy nga tre modulet e hartuara për psikologët e sistemit të Drejtësisë.
Trajnimet do të realizohen çdo vit në mënyrë periodike nga Urdhri i Psikologut”.
- 13- Vendimi Nr.13 datë 02.05.2023** “Të mos pranohet ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.2 datë 08.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.2 datë 08.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënien e masës disiplinore: “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”.
- 14- Vendimi Nr.14 datë 02.05.2023** “Të mos pranohet ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.1 datë 08.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional”.
Të lërë në fuqi Vendimin Nr.1 datë 08.03.2023 të



URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënie e masës disiplinore: “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”.

15-Vendimi Nr.15 datë 02.05.2023 “Të mos pranojë ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.4 datë 16.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.4 datë 16.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënie e masës disiplinore: “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 9 (nëntë) mujore”.

16- Vendimi Nr.16 datë 02.05.2023 “Të mos pranojë ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.7 datë 16.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.7 datë 16.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënie e masës disiplinore: “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”.

17-Vendimi Nr.17 datë 02.05.2023 “Të mos pranojë ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.6 datë 16.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.6 datë 16.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënie e masës disiplinore: “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”.

18-Vendimi Nr.18 datë 02.05.2023 “Të miratojë me 8 vota pro, 1 apstenim nga 9 anëtarë të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje Buxhetin Faktik 2022 shoqëruar me relacionin përkatës.

19- Vendimi Nr.19 datë 22.05.2023 “Të mos pranojë ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.11 datë 29.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.11 datë 29.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënie e masës disiplinore: “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”.

20- Vendimi Nr.20 datë 22.05.2023 “Të miratojë me 8 vota pro, asnjë kundër, 2 apstenim nga 10 anëtarët e Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje ngritjen e grupit ad-hoc në vijim të procesit për vlerësimin e dokumentacionit të depozituar pranë Urdhrit të Psikologut, për psikologët të cilët janë pjesë e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve në Ministrinë e Drejtësisë”.

21-Vendimi Nr.21 datë 29.05.2023 “Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, ndryshimin e Statutit të Urdhrit të Psikologut, Neni 12 pika 1.d) e tij”.

22-Vendimi Nr.22 datë 29.05.2023 “Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, ndryshimet në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor e Profesional të Urdhrit të Psikologut, neni 7 dhe neni 13 i saj”.

23-Vendimi Nr.23 datë 29.05.2023 “Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, ndryshimet në Kodin Etik e Deontologjik të Urdhrit të Psikologut, Standardet 1.06, 2.01, 2.05 të tij.

Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, shtimin e Standardit 5.07 në Kodin Etik e Deontologjik të Urdhrit të Psikologut”.

24-Vendimi Nr.24 datë 29.05.2023 “Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje ngritjen e grupit ad-hoc për shqyrtimin e detajuar të ankesës për Vendimin Nr.13, datë 13.04.2023 të Komisionit Etik”.

25-Vendimi Nr.25 datë 19.06.2023 “Të mos pranojë ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.13 datë 13.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.13 datë 13.03.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënie e masës disiplinore: “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 8 (tetë) mujore”.

26-Vendimi Nr.26 datë 19.06.2023: “Të mos pranojë ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.18 datë 04.05.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.18 datë 04.05.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënie e masës disiplinore : “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”.

27-Vendimi Nr.27 datë 19.06.2023 “Të mos pranojë ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.8 datë 24.04.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.8 datë 24.04.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënie



URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



e masës disiplinore: “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 6 (gjashtë) mujore”.

28-Vendimi Nr.28 datë 19.06.2023 “Të miratojë me 8 vota Pro, asnjë kundër dhe 2 abstenim Organigramën e Urdhrit të Psikologut.

29- Vendimi Nr.29, datë 18.07.2023 “Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, ngritjen e Komisionit të Votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor.

Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje honorarin për pagesën e anëtarëve të Komisionit të Votimit në vlerën 5.000 lekë”.

30-Vendimi Nr.30, datë 24.07.2023 “Të miratojë ngritjen e Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor bazuar në rezultatin e votimit nga procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Votimit, për kandidaturat fituese si më poshtë”:

- 1.Blerina Toma
- 2.Brunilda Laboviti
- 3.Enila Cenko
- 4.Ela Tollkuçi
- 5.Elona Hasmujaj
6. Fatjona Hysi
7. Naureda Bajraktari
8. Orsjola Miho

31- Vendimi Nr.31, datë 07.11.2023 “Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje ndryshimet e propozuara të zyrës juridike, konkretisht:

Në Kreun 4, pika 4.2. të Rregullores së Edukimit në Vazhdim me emërtimin “Monitorimi dhe vlerësimi përfundimtar” të shtohen plotësimet e mëposhtme:

- 4.2. Eksperti i pavaruar ka detyrimin të monitorojë aktivitetin e edukimit në vazhdim për të siguruar zbatimin e standardeve dhe kriterëve të parashikuara. Pjesëmarrja e ekspertit të pavaruar me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit, duhet të jetë jo më pak se 70% të orëve efektive të secilës ditë të aktivitetit.
- Në Kreun 4, pika 4.4. të Rregullores së Edukimit në Vazhdim me emërtimin “Monitorimi dhe vlerësimi përfundimtar” të shtohen plotësimet e mëposhtme: 4.4. Pas përfundimit të aktivitetit, ofruesi duhet të kryejë procesin e vlerësimit,

duke dorëzuar pranë ekspertit të pavarur listën e pjesëmarrësve në aktivitet dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të aktivitetit të kryera nga vetë ofruesi, si dhe nga pjesëmarrësit në aktivitet. Frekuentimi i pjesëmarrësve duhet të jetë jo më pak se 85% të orëve efektive të secilës ditë të aktivitetit.

32-Vendimi Nr.32, datë 07.11.2023 “Të miratojë me 8 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim, ndryshimin në Rregulloren e Menaxhimit Financiar, neni 6, pika 5 e saj, lidhur me honoraret e dietave jashtë vendit, nga masa 30 – 60 Euro dita në masën 40 -100 Euro dita”.

33-Vendimi Nr.33, datë 07.11.2023 “Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent, pagën për pozicionin e Drejtorit të Burimeve Njerëzore në vlerën 75000 ALL neto”.

34-Vendimi Nr.34, datë 07.11.2023 “Të mos pranojë ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.22 datë 21.09.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.22 datë 21.09.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënien e masës disiplinore: “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 10 (dhjetë) mujore”.

35-Vendimi Nr.35, datë 07.11.2023 “Të mos pranojë ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.23 datë 21.09.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional”.

Të lërë në fuqi Vendimin Nr.23 datë 21.09.2023 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënien e masës disiplinore : “Përrjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 18 (tetëmbëdhjetë) mujore”.

36-Vendimi Nr.36, datë 21.12.2023 “Të përjashtojë nga diskutimet dhe votimi përfundimtar, Variantin 1 dhe Variantin 2 të Projekt-Buxhetit për vitin financiar 2024, me 11 vota pro, 1 kundër të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje”.

37-Vendimi Nr.37, datë 21.12.2023 “Të miratojë me 11 vota pro, 1 kundër, Projekt-Buxhetin e vitit financiar 2024 me tarifat e ndryshuara sipas tabelës bashkëngjitur”.



URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Kuotizacion i Psikologëve të licencuar ekspertë në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve	15.000 Lekë	15.000 Lekë
Regjistrim/ Riregjistrim	2.000 Lekë	5.000 Lekë
Kartoni i Licencës	15.000 Lekë	20.000 Lekë
Vërtetim	200 Lekë	500 Lekë
Certifikatë Good Standing	200 Lekë	10.000 Lekë
Provim i Vlerësimit të Aftësimit Praktik	3.000 Lekë	5.000 Lekë
Honorari anëtarëve të Komisioni i Licencimit	3.000 Lekë	5.000 Lekë
Honorari anëtarëve të Komisioni i Praktikës	3.000 Lekë	5.000 Lekë

38-Vendim Nr.38, datë 21.12.2023 “Të miratojë me unanimitet ngritjen e grupit Ad-Hoc lidhur me vlerësimin e situatës dhe për mënyrën si do të ecim për standardizimin e testeve”
Në përbërje të grupit Ad-Hoc do të jetë një psikolog dhe një ekspert i kërkimit shkencor”.



2.3 KOMISIONI I GJYKIMIT DISIPLINOR PROFESIONAL

Ky komision është ngritur pranë Urdhrit të Psikologut në zbatim të nenit 19 të Ligjit nr. 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut”.

Komisioni Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional ka në strukturën e tij 5 anëtarë prej të cilëve 4 psikologë me një eksperiencë pune mbi 10-vjecare në profesion dhe përfaqësuesin e Zyrës Juridike të Urdhrit:

Dr.Jonida Haxhiu, Dr.Enila Cenka, Dr.Brunilda Laboviti, Dr.Redina Balla dhe juristi i Urdhrit Z.Igli Çutra

Komisioni funksionon në bazë të ligjit për Urdhrin e Psikologut, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë si dhe Rregullores së Gjykimit Disiplinor e Profesional.

Pas përfundimit të mandatit të komisionit në datë 24.07.2023 Këshilli Kombëtar miratoi ngritjen e Komisionit Etik të Gjykimit Disiplinor bazuar në rezultatin e votimit nga procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Votimit, për kandidaturat fituese si më poshtë:

Dr.Brunilda Laboviti, Dr.Enila Cenka, Dr. Ela Tollkuçi, Dr. Elona Hasmuaj, Dr.në proces Fatjona Hysi, Msc.Naureda Bajraktari, Msc. Blerina Toma, Msc.Orsjola Miha

Gjatë vitit 2023 Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional ka shqyrtuar gjithsej 25 raste të iniciuara.

Komisioni i Etikës pas shqyrtimit të rasteve ka dhënë këto vendime:

Në 16 raste janë konstatuar shkelje të Kodit të Etikës dhe janë dhënë masa të ndryshme disiplinore kundrejt psikologëve të tilla si: vërejtje me paralajmërim si dhe përjashtim nga U.P. për një periudhë 6 mujore, 9 mujore, 8 mujore, 12 mujore dhe 18 mujore.

Në 9 raste, pas shqyrtimit të çështjes, Komisioni Etik nuk ka konstatuar raste të shkeljes së Kodit të Etikës, ndaj kërkesat e palëve ankuese janë rrëzuar.

KOMISIONI I GJYKIMIT DISIPLINOR PROFESIONAL



Dr. Brunilda Laboviti



Z. Igli Çutra



Znj. Jonida Haxhlu



Znj. Redina Balla



Znj. Enila Cenka



2.4 KOMISIONI I EDUKIMIT NË VAZHDIM NË PSIKOLOGJI

Në bazë të akteve ligjore në fuqi, ky Komision zgjidhet nga Këshilli Kombëtar dhe drejtohet nga Presidenti i Urdhrit. Në përbërje të tij janë anëtarët e mëposhtëm:

Znj.Ardiana Mali, Znj.Erika Melonashi, Znj. Marsela Shehu, Znj.Valmira Skëndi dhe Znj.Valbona Treska në cilësinë e Presidentes së U.P.

Ky Komision vijoi punën normalisht gjatë vitit 2023, duke shqyrtuar aplikimet për akreditim, kërkesat për ripërsëritje të aktiviteteve të subjekteve

të cilat ishin të interesuara të kryenin aktivitete të akredituara të edukimit në vazhdim në psikologji si dhe miratim të krediteve në kuadër të rilicensimit, për psikologët të cilët kanë qenë në fund të vlefshmërisë së licensave të tyre.

Viti 2023 ka qenë një vit i ngarkuar për Komisionin e Edukimit në Vazhdim pasi ka patur rreth 330 dosje për njohje dhe rishikim kreditesh për efekt të procesit të rilicensimit të psikologëve.

KOMISIONI I EDUKIMIT NË VAZHDIM



Dr. Valbona Treska



Znj. Valmira Skëndi



Znj. Ardiana Mali



Znj. Erika Melonashi



Znj. Marsela Shehu



2.5 ADMINISTRATA E URDHRI TË PSIKOLOGUT



Administrata e Urdhrit të Psikologut përbëhet nga:
Zyra Juridike – një punonjës, Z.Igli Çutra
Zyra e Financës – një punonjës, Z.Lejdi Goga,
zëvendësuar me Z.Geri Ahemtaliaj.
Sekretariati, Protokolli, Arshiva – një punonjëse,
Znj.Armira Baboçi
Specialist i Edukimit në Vazhdim – një punonjëse
me kohë të pjesshme Znj.Geirsa Zelo
Zyra e IT-së – një punonjës, Z.Enn Tusha





2.6 KOMISIONE TË TJERA

Pranë Urdhrit të Psikologut funksionojnë disa komisione të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e misionit të tij ligjorë.

2.6.1 Komisioni i Licencimit

Ky Komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut dhe shqyrton kërkesat për licencim të të gjithë atyre psikologëve, që në bazë të ligjit dhe akteve normative në fuqi, përjashtohen nga

detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale dhe provimit të shtetit.

Ai përbëhet nga Presidentja Znj.Valbona Treska, juristi Z.Igli Çutra, sekretaria Znj.Armira Baboçi si dhe nga anëtarët e Këshillit Kombëtar: Dr.Edvin Lame dhe Dr.Fleura Shkëmbi

Gjatë vitit 2023 ky komision ka licencuar 17 psikologë të rinj, të ndarë sipas fushave të mëposhtme:

Psikologë Klinikë	12 anëtarë
Psikologë Shkollorë	1 anëtar
Psikologë Këshillimi	2 anëtarë
Psikologë Organizacionalë	1 anëtar
Psikologë Ligjorë	1 anëtar

KOMISIONI I LICENCIMIT



Dr. Valbona Treska



Z. Edvin Lame



Dr. Fleura Shkëmbi



Znj. Armira Baboçi



Z. Igli Çutra

Gjatë vitit 2023 i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të njohjes së krediteve dhe rilicencimit 191 psikologë. Po ashtu gjatë vitit 2023 kanë kaluar me sukses provimin e shtetit 39 psikologë të cilëve u është miratuar nga Komisioni i Licencimit e drejta e ushtrimit të profesionit (Licenca) sipas fushave të mëposhtme:

Psikologë klinikë - 15 anëtarë
Psikologë këshillimi - 2 anëtarë
Psikologë shkollorë- 11 anëtarë
Psikologë shkollorë dhe zhvillimi- 2 anëtarë
Psikologë shkollorë dhe edukimi- 1 anëtarë
Psikologë në institucione – 3 anëtarë
Psikologë ligjorë - 2 anëtarë
Psikologë në orientim profesional - 1 anëtarë
Psikologë organizacionalë - 2 anëtarë



2.6.2 Komisioni i Praktikës Profesionale

Ky komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar për efekt të zbatimit të “Rregullores së Praktikës Profesionale”, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e autoritetit kompetent, e cila mundëson rregullimin ligjor të vijimit të procedurave për një numër të konsiderueshëm psikologësh të sapodiplomuar dhe përjashtimin nga kjo praktikë për një kategori tjetër.

Komisioni i Praktikës Profesionale drejtohet nga Presidenti i Urdhrit dhe përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga Këshilli Kombëtar, konkretisht: Dr.Valbona Habili, Znj.Orjola Plaku, juristi i Urdhrit të Psikologut Z.Igli Çutra dhe sekretaria Znj.Armira Baboçi.

Këtë vit janë regjistruar pranë Urdhrit të Psikologut 166 praktikantë me kontrata të rregullta punësimi në institucione të ndryshme shtetërore e private.

Komisioni i Praktikës ka shqyrtuar gjatë vitit 2023 dosjet e 22 psikologëve dhe, pas shqyrtimit të tyre ka vendosur:

- 8 psikologë të përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së praktikës profesionale, bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit mes U.P dhe MSHMS
- 5 psikologë janë vlerësuar se duhet të kryejnë praktikë të pjesshme profesionale.
- 9 psikologë janë vlerësuar se duhet të kryejnë praktikën e plotë profesionale.

2.6.3 Komisioni i Vlerësimit të Aftësisimit Praktik

Ky komision është ngritur bazuar në Urdhrin Nr.580, datë 31.07.2019 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit e Aftësimin Praktik për Profesionin e Psikologut” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka si qëllim të vlerësojë praktikën profesionale të supervizuar të çdo psikologu që i nënshtrohet kësaj procedure.

Me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në nenin 17 të Urdhrit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe


KOMISIONI I PRAKTIKËS PROFESIONALE



Dr. Valbona Treska



Z. Igli Çutra



Znj. Valbona Habili



Znj. Erjola Plaku



Znj. Armira Baboçi



Ministrisë së Shëndetësisë, “Për miratimin e Rregullores së Praktikës Profesionale” anëtarët e këtij komisioni janë si më poshtë: Znj.Aleksandra Puci, kryetare e komisionit dhe përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Z.Besmir Frroku dhe Z.EdvinLame, përfaqësues të Urdhrit të Psikologut. Komisioni ka hartuar fillimisht pyetjet orientuese për provimin e praktikës profesionale, pyetje të cilat janë publikuar paraprakisht në Website-n e Urdhrit të Psikologut <https://www.urdhriipsikologut.al/fondi-i-pyetjeve> sipas afateve të parashikuara në rregullore.

Gjatë vitit 2023 u zhvillua Vlerësimi i Aftësimit Praktik në datat 24-26 Maj si dhe 5-7 dhjetor pranë ambjenteve të Urdhrit të Psikologut.

Në listën e provimit të muajit maj ishin 88 praktikantë të cilët ju nënshtruan vlerësimit të anëtarëve të komisionit të VAP-it, prej te cilëve 2 praktikantë nuk u paraqitën ditën e provimit.

Në listën e provimit të muajit dhjetor ishin 81 praktikantë të cilët ju nënshtruan vlerësimit të anëtarëve të komisionit të VAP-it, prej te cilëve 2 praktikantë nuk u paraqitën ditën e provimit.

Në total gjatë vitit 2023, 164 psikologë praktikantë janë vlerësuar Kalueshëm nga KVAP, 4 psikologë nuk janë paraqitur në provim dhe 1 psikolog është vlerësuar Jokalueshëm.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË AFTËSIMIT PRAKTIK



Znj. Aleksandra Puci



Z. Edvin Lame



Z. Besmir Frroku



2.7 KOORDINATORËT LOKALË

Rrjeti i koordinatorëve lokalë ka si qëllim ofrimin e mbështetjes, ndihmës dhe mbrojtjes së interesave për të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut të qarkut përkatës, duke patur në fokus nevojat dhe problematikat që ata ndeshin gjatë ushtrimit të profesionit të psikologut. Ky rrjet funksion në mënyrë vullnetare.

Koordinatori lokal ka si mision:

- Kryerjen e shërbimeve për anëtarët e Urdhrit, në kuadër të shpërndarjes efektive të informacioneve që lidhen me ushtrimin e profesionit, mbledhjes dhe shpërndarjes së dokumentacionit specifik, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ushtrimit të profesionit të psikologut në institucionet përkatëse rajonale dhe uljen e kostove për përfitimin e këtyre shërbimeve për anëtarët e Urdhrit në qark.
- Vendosijen dhe ruajtjen e marrëdhënieve të Urdhrit me organet vendore dhe subjektet e tjera publike dhe private në rajon, me qëllim rritjen e ndikimit dhe faktorizimin e Urdhrit të Psikologut.

Disa nga funksionet që kryejnë Koordinatorët Lokalë janë:

- Dhënia e informacionit të detajuar për çdo psikolog, i cili do të kryejë procedurat e anëtarësimit, licencimit, zhvillimit të praktikës profesionale, provimit të shtetit, kryerjen e trajnimeve të ndryshme, etj.
- Mbledhja e të gjitha dokumentave të nevojshme të psikologëve të rajonit përkatës, përsa i përket procedurës së anëtarësimit-licencimit, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me Urdhrin, dhe përcjellja e tyre pranë Urdhrit të Psikologut.
- Shpërndarja për psikologët e rajonit përkatës të lejes së ushtrimit individual të profesionit (Licencave Profesionale) apo e çdo dokumentacioni tjetër të lëshuar nga Urdhri për anëtarët e këtij rajoni.
- Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit, brenda rajonit, me institucionet publike, si dhe me çdo subjekt tjetër publik apo privat, që ka qëllime të përbashkëta me Urdhrin e Psikologut.
- Informimi i psikologëve të rajonit lidhur me vendimet dhe udhëzimet e Urdhrit të Psikologut.

- Mbështetja për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore e shkencore në fushën e psikologjisë në rajon.
- Gjithashtu, Koordinatorët Lokalë pranojnë çdo ankesë të ardhur në drejtim të psikologëve, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues, dhe e dërgojnë atë pranë Zyrës Qëndrore të Urdhrit të Psikologut, me qëllim iniciimin e procedurave të shqyrtimit nga Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional.
Aktualisht, shpërndarja e rrjetit të koordinatorëve është si më poshtë:

Koordinatori Lokal për Qarkun e Shkodrës

Migena Burrja/Haxhi

Adresa: Rr "At Gjergj Fishta" Nd.37 Kati I-rë

Tel: 0693129434

e-mail: Qarkushkoder@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Vlorës

Veliona Hoxhaj

Adresa: Rr "Sulejman Delvina" Lagjja Hajro Cakerri, Pallati Lor, Kati II-të

Tel: 0674060444

e-mail: Qarkuvlore@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Lezhës:

Znj.Alma Shyti

Adresa: Shkolla "Kolin Gjoka"

Tel: 0683296435

e-mail: Qarkulezhe@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Korçës:

Znj.Elizaveta Dino

Adresa: Qendra e Shëndetit Mendor, Korçë

Tel.: 0696171870

e-mail: Qarkukorce@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Elbasanit

Znj.Jonida Mustafaraj

Adresa: Qendra Shqiptare per Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Vecanta

Tel: 0693847103

e-mail: Qarkuelbasan@urdhriipsikologut.al



**URDHRI I PSIKOLOGUT
RAPORTI VJETOR 2023**



Koordinatori Lokal për Qytetin e Lushnjës

Znj.Fatmira Lala

Adresa: Shkolla “Kongresi i Lushnjes”

Tel: 0692626443

e-mail: koordinatorlokallushnje@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Dibrës

Znj.Arta Beqiri

Adresa: Bulqizë

Tel: 0698220502

e-mail: Qarkudiber@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Gjirokastrës

Znj.Loreta Mamani

Adresa: Gjirokastrë

Tel: 0694640798

e-mail: Qarkugjirokaster@urdhriipsikologut.al



3. ANËTARËSIA E URDHRI TË PSIKOLOGUT

Për të qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, psikologët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë;
- b) të kenë diplomën e studimeve të larta “Bachelor” dhe “Master shkencor” ose “Master profesional” në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- c) të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;
- ç) të mos jenë të dënuar me vendim gjykatë të

formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim.

Anëtarësia ka patur një rritje gjatë vitit 2023. Administrata e Urdhrit në vazhdimësi ka bërë një punë të madhe sensibilizuese kundrejt psikologëve, por edhe kundrejt institucioneve publike e private, të cilat janë ndërgjegjësuar për nevojën e zbatimit të ligjit.

Në total Urdhri i Psikologut për vitin 2023 ka arritur në 1577 anëtarë të regjistruar aktivë prej të cilëve janë 178 anëtarë të rinj të regjistruar për herë të parë gjatë këtij viti.

3.1 PSIKOLOGË TË LICENCUAR

Licencimi i psikologëve rregullohet në bazë të Ligjit “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij ligji, pas përmbylljes së studimeve Bachelor dhe Master në psikologji, duhet të kryhet praktika një vjeçare profesionale dhe më pas të jepet provimi i shtetit, si parakusht për licencimin.

Përfundimisht, në këtë ligj parashikohet se psikologët, të cilët e kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Urdhri ka vijuar procesin e licencimit për këtë kategori të psikologëve, bazuar në Ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në R.Sh”¹

dhe Memorandumin e Bashkëpunimit mes ish-Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Urdhrit të Psikologut.

¹ Neni 9 i Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), pika 4.:Përjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit: a) profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar;



URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Aktualisht, licencimi i psikologëve sipas fushës së kompetencës paraqitet si më poshtë:

Psikologë të licencuar sipas viteve	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Total
Total të Licencuar	307	175	71	101	74	130	351	1209
Psikologë Klinikë	147	97	32	32	35	80	155	578
Psikologë Shkollorë Organizacionalë	48	19	14	7	4	4	34	130
Psikologë Shkollorë	28	14	3	27	11	51	43	177
Psikologë Organizacionalë	8	13	2	7	5	10	16	61
Psikologë në Institucione	17	6	3	5	3	18	15	67
Psikologë në Orientim Profesional	9	3	2	1	2	7	10	34
Psikologë në Këshillim Psikologjik	41	25	9	18	10	36	49	190
Psikologë në Kërkim Psikologjik	5	2	2	1	-	-	-	10
Psikologë Ligjorë	5	2	2	3	2	2	10	26
Psikologë të Përgjithshëm	8	2	6	2	1	8	6	33
Psikologë Komuniteti	2	-	-	1	-	-	-	3
Psikologji Sociale	-	-	-	-	-	-	1	1
Psikologë në Rehabilitim psikologjik	1	-	-	-	-	-	-	1
Psikologë Edukimi	-	-	-	1	1	2	4	8
Psikologë Zhvillimi	-	-	-	1	1	-	-	2
Gjuhesi Klinike	-	-	-	-	1	-	-	1
Psikopatologji Klinike	-	-	-	-	1	-	-	1
Neuroshkenca dhe rehabilitim psikologjik	-	-	-	-	-	-	1	1
Kriminale	-	-	-	-	-	1	-	1
Këshillim Klinik	-	-	-	-	-	1	2	3
Shkollore dhe Zhvillimi	-	-	-	-	-	4	-	4
Shkollore dhe Edukimi	-	-	-	-	-	-	4	4
Psikologji Biznesi	-	-	-	-	-	-	1	1

Gjatë vitit 2023 janë licencuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë 17 psikologë dhe 39 të tjerë me Provim Shteti, në total 56 psikologë të rinj. Pjesa tjetër e psikologëve të regjistruar në dhjetor për Provim

Shteti do t'i nënështrohen provimit në fillim të vitit 2024.

Ndërkohë i janë nënshtruar procesit të rilicencimit 284 psikologë.



4. PROVIMI I SHKETIT PËR PSIKOLOGËT

Në datë 15.09.2023 u zhvillua Provimi i Shtetit për psikologët, të cilët kishin përfunduar Praktikën Profesionale apo që ishin përfunduar me vendim të Komisionit të Praktikës nga detyrimi për kryerjen e Provimit të Shtetit. Në këtë provim morën pjesë 104 psikologë.

Provimi i Shtetit ishte i organizuar në një mënyrë të tillë ku pjesën më të madhe të pyetjeve e përmbante cikli Bachelor, konkretisht në masën 70% të pyetjeve në total, ndërsa pjesa tjetër ishin pyetje nga cikli

Master, i ndarë sipas 5 fushave: Psikologji në fushën e Shëndetit Mendor, Psikologji në fushën e Edukimit, Psikologji në fushën e Punës dhe Organizacionale, Psikologji në fushën Juridike dhe Psikologji në fushën Sociale dhe të Komunitetit.

Në përfundim të këtij provimi rezultoi:

- 39 psikologë rezultuan kalues
- 65 psikologë rezultuan jo kalues
- 6 psikologë munguan





5. BUXHETI

5.1 TË ARDHURAT

Buxheti faktik i vitit 2023 u hartua me ndihmën e ekspertëve kontabël të jashtëm dhe synoi të garantonte vazhdimësinë institucionale dhe të plotësonte nevojat për përmbushjen e aktivitetit të pritshëm në vitin në vazhdim.

Zërat kryesorë të të ardhurave për vitin fiskal 2023 janë:

Emërtimi i zërave	Të ardhura në total
Të ardhura nga tarifa e anëtarësimit	568,175.00
Të ardhura nga kuotizacionet vjetore	8,638,022.00
Të ardhura nga tarifa e licensimit	5,600,195.00
Të ardhura nga botime dhe publikime	10,200.00
Të ardhura nga tarifa për Edukimin në vazhdim	3,238,935.00
Të ardhura nga vërtetime anëtarësie	59,493.00
Të ardhura nga Komisioni i Vlerësimit të Aftësisimit Praktik	543,099.00
Të ardhura nga trajnime të tjera	1,275,015.00
Totali i të ardhurave	19,933,134.00

Nga informacioni i marrë nga tabela, e mësipërme rezulton se është realizuar një total të ardhurash neto të pakufizuara në vlerën 19,933,134.00 lekë, ku kryesisht grumbullimi i këtyre të ardhurave konsiston në tarifën vjetore të kuotizacionit sipas kategorive të

anëtarëve, tarifën për tërheqjen e kartonit të licences, totali i të ardhurave të mbledhura nga aktivitetet e edukimit në vazhdim si edhe të ardhura nga zërat e tjera që Urdhri disponon.

5.2 SHPENZIMET

Nisur nga eksperiencia e viteve të kaluara, për efekt të disiplinimit sa më transparent të të ardhurave, është ruajtur një balancë e shpenzimeve të detyrueshme për t'u realizuar sipas planifikimit.

Duke mbajtur në konsideratë parashikimet për kryerjen e shpenzimeve, më poshtë do gjeni të pasqyruara në tabelën përmbledhëse shpenzimet faktike të ndara sipas zërave për vitin 2023.



URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Zërat kryesorë të shpenzimeve për vitin fiskal 2023 janë:

Emërtimi i zërave	Shpenzime në total
Shpenzime për paga	6,918,350.00
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	1,152,634.00
Totali i shpenzimeve për paga	8,070,984.00
Shpenzime për honorare	5,334,613.00
Shpenzime për qera	734,419.00
Shpenzime administrative të funksionimit	1,356,114.00
Shpenzime për aktivitete brenda dhe jashtë vendit dhe mardhënie ndërkombëtare	2,030,639.00
Shpenzime për printime, publikime dhe menaxhimi ne Web	1,080,218.00
Shpenzime për veprime bankare	134,194.00
Totali i shpenzimeve operative	5,335,584.00
Shpenzime amortizimi për inventar zyre	83,776.00
Shpenzime amortizimi për paisje informatike	133,699.00
Shpenzime për zhvlerësim AAM	74,217.00
Totali i shpenzimeve të amortizimit	291,692.00
Totali i shpenzimeve vjetore	19,032,873.00

Duke krahasuar buxhetin faktik dhe projekt-buxhetin rezulton se Urdhri i Psikologut i është përmbajtur shpenzimeve të projektuara.

Në zërin e shpenzimeve operative janë shpenzuar 5,335,584.00 lekë. Kjo vlerë ka ardhur si rezultati i realizimit të të gjithë shpenzimeve që përfshihen në kategorinë e shpenzimeve operative. Ndër shpenzimet më kryesor që zënë dhe pjesën më të madhe në buxhet janë:

1. Shpenzime për aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat përfshijnë përveç realizimit të aktiviteteve edhe pjesëmarrjes në to edhe tarifa të detyrueshme vjetore të anëtarësimit në organizata.
2. Shpenzime administrative të funksionit, të cilat përfshijnë kryesisht shpenzime kancelarie, utilitare, përkthimi, mirëmbajtje etj.

3. Shpenzime për materiale të printuara, publikime dhe menaxhimi Web, një vend të rëndësishëm tek të cilat zënë tarifat vjetore të web në tërësi, printimi i kartave dhe licencave të anëtarësisë, si edhe materiale informuese për aktivitete të ndryshme.

Gjatë vitit 2023 zëri i shpenzime “amortizime kapitale” është zhvlerësuar në masën 291,692.00 lekë, ku llogaritja e zhvlerësimit paraqitet me vlerën e drejtë dhe me pas kjo kosto amortizohet sipas metodes së Interesit Efektiv marrë nga (SKK) duke zbritur çdo humbje apo zhvlerësim.

Më poshtë paraqitet e detajuar në zëra një tabelë përmbledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të vitit fiskal 2023.



URDHRI I PSIKOLOGUT RAPORTI VJETOR 2023



Emërtimi i zërave	Të ardhura në total
Të ardhura nga tarifa e anëtarësimit	568,175.00
Të ardhura nga kuotizacionet vjetore	8,638,022.00
Të ardhura nga tarifa e licensimit	5,600,195.00
Të ardhura nga botime dhe publikime	10,200.00
Të ardhura nga tarifa për Edukimin në vazhdim	3,238,935.00
Të ardhura nga vërtetime anëtarësie	59,493.00
Të ardhura nga komisioni i Vlerësimit të Aftësisimit Praktik	543,099.00
Të ardhura nga trajnime të tjera	1,275,015.00
Totali i të ardhurave	19,933,134.00
Emërtimi i Shpenzimeve	Shpenzime në total
Shpenzime për paga dhe sigurime	8,070,984.00
Shpenzime për honorare	5,334,613.00
Totali i shpenzimeve operative	5,335,584.00
Totali i shpenzimeve të amortizimit	291,692.00
Totali i shpenzimeve vjetore	19,032,873.00
Mbetja për vitin pasardhës	900,261.00

Buxheti faktik i vitit 2023 shfaq se kemi një balancë të brishtë mes të ardhurave të mbledhura dhe shpenzimeve faktike të detyrueshme për funksionimin e institucionit gjatë vitit 2024. Mbetja financiare e vitit 2023 rezulton të jetë në masën 900,261.00 lekë, duke mos përfshirë këtu fondin e emergjencës në masën 2.500.000 lekë.

Në kuadër të këtij buxheti faktik paraprak të realizuar në fund të vitit 2023 nga Zyra e Financës, u ndërmorën në dhjetor 2023 politika të reja financiare të Këshillit Kombëtar për ndryshimin e kuotave dhe tarifave me qëllimin funksionimin e Urdhrit të Psikologut në përmbushje të misionit të tij ligjor.

Gjatë vitit 2023 janë arkëtuar 2,560,005.00 lekë për trajnimin e psikologut në drejtësi i cili është zhvillua nga data 03 nëntor 2023 deri në datën 07 shkurt 2024.

Duke qenë se trajnimi është zhvilluar në dy periudha të ndryshme kohore të mbylljes së pasqyrave financiare, 2023 dhe 2024, ky arkëtim është deklaruar në pasqyrat financiare të vitit 2023 si e ardhur e shtyrë (apo e ardhur e periudhave të ardhëshme).

Në pasqyrat financiare që do të përgatiten për vitin 2024, kjo e ardhur e shtyrë si dhe të gjitha shpenzimet që janë kryer për të, do të paraqiten si të ardhura dhe shpenzime faktike të vitit 2024.



6. OBJEKTIVAT E REALIZUAR GJATË VITIT 2023

- Vazhdimi i procesit të formalizimit të ushtrimit të profesionit, nëpërmjet rritjes së numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- Realizimi në vazhdimësi i provimeve të Vlerësimit të Aftësisë Praktik, si parakusht i pjesëmarrjes në Provimin e Shtetit.
- Realizimi i Provimit të Shtetit në bashkëpunimin me Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
- Realizimi i procesit të njohjes së krediteve për kategorinë e psikologëve që kanë përfunduar vlefshmërinë e lejes së ushtrimit të profesionit.
- Rregullimi i profesionit nëpërmjet fushës së kompetencës të psikologut në të gjitha institucionet nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm.
- Fuqizimi i rolit të psikologut në fushën e Drejtësisë dhe ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për këtë kategori psikologësh sipas fushës së kompetencës.
- Realizimi i provimit të rilicensimit për kategorinë e psikologëve që nuk kishin arritur të përmbushim numrin e krediteve të nevojshme për të rinovuar Lejen e Ushtrimit të Profesionit.
- Organizimi, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar dhe vendas, i cikleve të trajnimeve apo leksioneve të hapura, me qëllim formimin e psikologëve të specializuar për ndërhyrje në situata dhe problematika të caktuara.
- Rritja e bashkëpunimit me Federatën Europiane të Psikologëve me qëllim rritjen e standardeve profesionale.
- Përfundimi i raportit dhe finalizimi i aplikimit për të marrë Certifikatën EuroPsy.



7. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024

Objektivat që institucioni ynë synon të realizojë përgjatë vitit 2024 janë:

- Vazhdimi i procesit të formalizimit të ushtrimit të profesionit, nëpërmjet rritjes së numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- Realizimi në vazhdimësi i provimeve të Vlerësimit të Aftësisimit Praktik, si parakusht i pjesëmarrjes në provimin e shtetit.
- Realizimi në vazhdimësi i organizimit të Provimit të Shtetit për psikologët nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
- Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit të koordinatorëve lokalë
- Vazhdimi i punës për rregullimin e profesionit nëpërmjet fushës së kompetencës për të gjithë psikologët që e ushtrojnë profesionin.
- Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për kategorinë e psikologëve për të cilët tregu nuk ofron trajnime, me qëllim përmbushjen e kriterëve të Edukimit në Vazhdim.
- Fuqizimi nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimit të psikologëve, në lidhje me ushtrimin e profesionit të psikologut brenda fushave të tyre të kompetencës.
- Organizimi, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar dhe vendas, i cikleve të trajnimeve, me qëllim formimin e psikologëve të specializuar për ndërhyrje në situata dhe problematika të caktuara.
- Rritja e bashkëpunimit me Federatën Evropiane të Psikologëve dhe Shoqatën e Psikologëve Amerikanë me qëllim rritjen e standardeve profesionale.
- Realizimi për herë të parë në Shqipëri i Semestrit të Psikologjisë të Federatës Evropiane të Shoqatave të Psikologëve.
- Rritja e bashkëpunimit me Shoqatën Evropiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAWOP), duke synuar jo vetëm përfaqësimin dinjitoz të Shqipërisë por edhe fuqizimin e rolit të psikologut të punës dhe organizacionalë në vendin tonë.

